

VENDIM
Nr. 49, datë 13.6.2018

**PËR FILLIMIN E PROCEDURËS PËR MARRJEN E MASAVE ADMINISTRATIVE
NDAJ SHOQËRISË UJËSJELLËS-KANALIZIME DIBËR SHA**

Në mbështetje të nenit 23, të ligjit nr. 8102, datë 28.3.1996, “Për kuadrin rregullator të sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit dhe përpunimit të ujërave të ndotura”, të ndryshuar, dhe të raportit nr. 80, datë 11.6.2018, përgatitur nga grupi i inspektimit, Komisioni Kombëtar Rregullator konstatoi:

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Dibër sh.a. ka detyrime të pashlyera të pagesës rregullatore ndaj Entit Rregullator të Ujit, në vlerën 1 412 100 (një milion e katërqind e dymbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë deri në datën 31.12.2017, të cilat burojnë nga kontrata mes Entit Rregullator të Ujit dhe Ujësjiellës-Kanalizime, e datës 26.7.2010 e në vazhdim.

Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Dibër sh.a. nuk zbaton vendimet e ERRU-së për tarifën. Vendimi për miratimin e tarifave për ujin e pijshëm ka hyrë në fuqi në datën 1.1.2010 dhe janë të vlefshme deri në miratimin e tarifave të reja, ndërsa vendimi për miratimin e ujërave të ndotura ka hyrë në fuqi në datën 1.7.2014 dhe ka qenë i vlefshëm për një afat kohor të caktuar deri më 1.7.2015.

Për gjithë sa më sipër, Komisioni Kombëtar Rregullator

VENDOSI:

1. Të fillojë procedurën e marrjes së masave administrative ndaj Shoqërisë Ujësjiellës-Kanalizime Dibër sh.a. për kundërvajtjet administrative:

- a) Mospagimi i detyrimeve financiare ndaj Entit Rregullator të Ujit;
- b) Për moszbatim të vendimeve të ERRU-së për tarifën;

2. Shoqëria Ujësjiellës-Kanalizime Dibër sh.a. ka 15 (pesëmbëdhjetë) ditë kohë nga marrja e këtij vendimi për të paraqitur kundërshtimet.

3. Drejtoria Juridike dhe e Konsumatorit ngarkohet të njoftojë Shoqërinë Ujësjiellës-Kanalizime Dibër sh.a. për vendimin e marrë nga Komisioni Kombëtar Rregullator.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Ndriçim Shani